



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim  
Agencija Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency



Data: 06/04/23 Ref.: 438/23

Në mbështetje të nenit 8 dhe 12 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administratjve Nr. 05/L-31, nenit 7 dhe 15 të Ligjit Nr.04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, Udhëzimin Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, si dhe Manualin e Akreditimit (*përditësuar me vendimin Ref.932/22*), Këshilli Shtetëror i Cilësisë i Agjencisë së Kosovës për Akreditim, në mbledhjen e 110-të, të mbajtur më 28.03.2023, mori:

### V E N D I M

- I. Ri/akreditohet Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (UShAF) në nivel institucional, për periudhën pesë (5) vjeçare, nga 1 tetor 2023 deri më 30 shtator 2028.
- II. Obligohet Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj që deri më datë 15.11.2023 të dorëzojë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit.
- III. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

### A R S Y E T I M I

Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj ka parashtruar kërkesë me Nr.prot. 1843/22 datë 28.10.2022 pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (në tekstin e mëtejme AKA) për riakreditim në nivel institucional.

AKA ka organizuar vizitë me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Universitetin e Shkencave të Aplikuara në Ferizaj me qëllim të vlerësimit në nivel institucional. Vizita është organizuar më datë 08.02.2023, me ekipin e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit me përbërje: Milan Pol, Peeter Normak dhe Christoph Back.


Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, Ekipi i Vlerësuesve të jashtëm (Ekspertëve ndërkombëtarë) ka hartuar raportin e vlerësimit dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka konstatuar se nga njëmbëdhjetë (11) fushat e standardeve të akreditimit, Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj është vlerësuar se përmbushë: plotësisht gjashtë (6) dhe substancialisht pesë (5).

Këshilli Shtetëror i Cilësisë në mbledhjen e 110 të mbajtur më 28.03.2023 ka shqyrtuar kërkesën/aplikacionin e Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitës si dhe në rekomandimin përfundimtar të dhënë në raportin final të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** *Kundër këtij vendimi pala mund të parashtrij ankesë sipas Ligjit Nr.05/L-031 mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative në organin që ka nxjerrë këtë vendim, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar.*

Vendimi ju dërgohet :

- Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.

  
Prof. Asoc. Dr. Hasnija Džaji  
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

